



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
DHE TURIZMIT

BASHKIA DURRËS
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Durrës, më ____ . ____ .2019

Lënda : Formulari i Njoftimit të Fituesit

Për: HTM + BE-IS shpk, Adresa: Shkoder, Lagja Perash, Rruga Kroje, Nr 44.

Procedura e prokurimit: Proçedurë “E hapur” Punë

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-24343-05-29-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës : Ndërtim shkolla 9 vjeçare Hamallaj, me fond limit: 65.885.000 lekë, sasia sipas preventivit, afati 180 ditë.

Publikime të mëparshme(*nëse zbatohet*):Buletini i Njoftimeve Publike. [Nr.22 datë 3 Qershor 2019]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X, oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. CARA	K07729920F
+ 2T	K01731001M
Vlera 42.161.748(dyzet e dy milion e njëqind e gjashtëdhjetë e një milion e shtatëqind e dyzet e tetë) lekë	
2. “M U R A T I”	J66702413V
+ EURO-ALB	K66613407H
+ AD-STAR	J69102207W
Vlera 42.390.603(dyzet e dy milion e treqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind e tre) lekë	
3. HTM	K97006004D
+ BE-IS shpk	K71412003A
Vlera 43.950.000(dyzet e tre milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë	
4. K.M.K	L78223801E

+ Caushi M	L88419801O
+ SINDER AB	K01531003W
+ SARDO	K13120402W
+ ALBKONSTRUKSION	J62903360G
Vlera 45.263.380(dyzet e pesë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e treqind e tetëdhjetë) lekë	
5. MODESTE	J62903413B
+ ED KONSTRUKSION	K61625001I
Vlera 45.800.609(dyzet e pesë milion e tetëqind mijë e gjashtëqind e nëntë) lekë	
6.LIQENI VII	K01730502W
+ NDREGJONI	K31329048I
Vlera 46.027.856(dyzet e gjashtë milion e njëzet e shtatë mijë e tetëqind e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë	
7.SHENDELLI	K07924803N
Vlera 46.823.022(dyzet e gjashtë milion e tetëqind e njëzet e tre mijë e njëzet e dy) lekë	
8. SHAMO-CONSTRUCTION	L01326020F
Vlera 48.785.127(dyzet e tetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e njëqind e njëzet e shtatë) lekë	
9. COMPANY RIVIERA 2008	K81716011V
+ KACDEDJA	K51712017A
Vlera 48.885.333(dyzet e tetë milion e tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë	
10. EVEREST	J78311921L
Vlera 49.227.292(dyzet e nëntë milion e dyqind e njëzet e shtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e dy) lekë	
11. KUPA	K51615512C
Vlera 49.511.839(dyzet e nëntë milion e pesëqind e njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e nëntë) lekë	
12. “SHKELQIMI 07”	K68121808W
Vlera 50.000.000(pesëdhjetë milion) lekë	
13. S I R E T A 2F	K51501008J
Vlera 52.588.333(pesëdhjetë e dy milion e pesëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë	
14. AURORA KONSTRUKSION	K02017003I
+ XHENGO	J64103171M

Vlera 52.604.757(pesëdhjetë e dy milion e gjashtëqind e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë

15. NDERTIMI shpk K11325002C

+ COLOMBO J82916489E

Vlera 53.727.934(pesëdhjetë e tre milion e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e nëntëqind e tridhjetë e katër) lekë

16. B-93 J62903508R

Vlera 54.030.053(pesëdhjetë e katër milion e tridhjetë mijë e pesëdhjetë e tre) lekë

17. INERTI J66926804L

Vlera 54.957.796(pesëdhjetë e katër milion e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë

18. LEON KONSTRUKSION

Vlera 56.661.100(pesëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e njëqind) lekë

19. ELDA-VL K67106202W

Nuk ka paraqitur oferte.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. CARA K07729920F

+ 2T K01731001M

2. "M U R A T I" J66702413V

+ EURO-ALB K66613407H

+ AD-STAR J69102207W

3.Shendelli K07924803N

4. SHAMO-CONSTRUCTION L01326020F

5. COMPANY RIVIERA 2008 K81716011V

+ KACDEDJA K51712017A

6. EVEREST J78311921L

7. KUPA K51615512C

8. "SHKELQIMI 07" K68121808W

9. S I R E T A 2F K51501008J

10. AURORA KONSTRUKSION K02017003I

+ XHENGO	J64103171M
11. B-93	J62903508R
12. ELDA-VL	K67106202W

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Për operatorët ekonomik në bashkim CARA + 2 T me vlerë të ofertës 42.161.748 lekë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kritereve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, konstatoi se:

- Në DST Shtojca 12, pika 2.1 “Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë”, germa “a”, kërkohet:

Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2019, referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Operatori në bashkim 2 T nuk i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2019. Referuar Ekstraktit të QKB të operatorit 2 T, lëshuar me datë 17/06/2019, rezulton se ky operator ushtron aktivitetin e tij Tiranë(seli qendrore) dhe në vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit, në Durrës, Elbasan, Pogradec dhe Korçë. Për bashkine Tiranë dhe bashkine Durrës operatori 2 T i ka plotësuar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2019, ndërsa për bashkitë Elbasan, Pogradec dhe Korçë, mungon dokumenti që vërteton se i ka plotësuar detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2019.

- Në DST Shtojca 12 , pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, ne gërmën “l” janë kërkuar;

List pagesat sipas formularëve standart për sigurimet, për gjashtë muajt e fundit (Dhjetor të vitit 2018 dhe Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj te vitit 2019, ndërsa subjektet e biznesit të vogël sipas legjislacionit në fuqi), ku numri i punonjësve të jetë minimumi 69 persona me kohë të plotë pune, këtu përfshihet: “Stafi teknik i shoqërisë” sipas pikës “h” dhe “Licenca profesionale të shoqërisë” sipas pikës “g” (sqarohet se: për “Mjekun”, do të zbatohet legjislacioni në fuqi). Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi (nëpërmjet formës elektronike).

Operatorët ekonomik në bashkim CARA+2 T e kanë plotësuar së bashku numrin e punonjesve 69 persona me kohë të plotë pune, por, sa i përket pikës së sipërcituar, ku thuhet se, ne List pagesat sipas

formularëve standart për sigurimet, për gjashtë muajt e fundit (Dhjetor të vitit 2018 dhe Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj te vitit 2019), duhet te përfshihet dhe stafi që bën pjesë në “Licencat profesionale të shoqërisë” sipas pikës “g”, rezulton se, operatori në bashkim CARA nuk ka përfshirë në listëpagesa, dy punonjës drejtues teknik, të cilët janë pjesë e stafit në licencën profesionale të shoqërisë CARA e konkretisht: Ne Licecën NZ.2175/19, të Shoqërisë “CARA”, Regjistruar në Regjistrin themeltar që nga data: 05.05.2016, drejtuesit teknik: ASLLAN SHUTINA dhe KLEANTH LAMI, mungojnë në List pagesat sipas formularëve standart për sigurimet, për gjashtë muajt e fundit (Dhjetor të vitit 2018 dhe Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj te vitit 2019). Operatori ekonomik CARA nuk e përmbush kriterin e lartekerkuar, ashtu sic kërkohet në DST, gjithashtu punëdhënësi CARA kishte detyrimin që në bazë të Ligjit “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, detyrohet të derdhë kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore për cdo punëmarrës.

- Në DST Shtojca 12, pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, në gërmën “k”, kërkuar si më poshtë;

Kërkohet certifikatë ISO 9001 e prodhuesit për cilësinë e produkteve të kërkuara më poshtë:

- *Pompa e kodenses per kaldajen :*
 - *prurja: jo me e < se 9 m³ / h*
- *Pompa e riqarkullimi :*
 - *Prurja: jo me e < se 8 m³ / h*
- *Ndricues fluoreshent 2 x 36 ë,IP40 (ose ekuivalent me te)*
- *F.v Ndricues tavanor 1 x 40 ë (ose ekuivalent me te)*
- *Ndricues projektor me llampe SAP-T 250 ë (ose ekuivalent me te)*

Për produktet e mësipërme, për rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues duhet të vërtetojë me marrëveshje bashkëpunimi(ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, e-mail, ëbbsite, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi, si dhe duhet të paraqiten dokumenta teknike (prospekte teknike, katalog etj.) të jenë të përkthyer në ato pjesë që pasqyrojnë specifikimet teknike që kërkohen në dokumentat e tenderit.

Operatorët ekonomik në bashkim CARA + 2 T, nëpërmjet operatorit në bashkim CARA, kanë bërë marrëveshje bashkëpunimi me distributor të prodhuesëve të produkteve e sipërcutara, por dokumentat teknike (prospekte teknike, katalog etj.) janë të pa përkthyer dhe të pa noterizuara në ato pjesë që pasqyrojnë specifikimet teknike që kërkohen në dokumentat e tenderit, kriter i kerkuar po në shtojcën 12 të dokumentave të tenderit, ku thuhet: “Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”.

KVO vendos që bashkimi i operatoreve ekonomikë CARA + 2 T të mos kualifikohet.

- Për operatorët ekonomik në bashkim “MURATI” +EURO-ALB +AD STAR” me vlerë të ofertës 42.390.603 lekë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se:

- Në DST Shtojca 12 , pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, në gërmën “f” është kërkuar:

Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 32'942'500 lekë, të realizuar gjatë tri viteve të fundit; ose Punë të ngjashme ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se 131'770'000 lekë; Si dëshmi për punë të ngjashme kërkohet: kontratën/kontratat me autoritetet kontraktore publike apo private të shoqëruara me faturën/faturat tatimore, formular vlerësimi sipas shtojcës e shoqëruar me akt kolaudimin dhe situacionet.

Në mbështetje të Vendimit nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht neni 74 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, në pikën 3 të saj thuhet:

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 6, të nenit 26, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtarë, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Theksojmë se në shkronjën “a” të pikës 6, të nenit 26, të këtyre rregullave, thuhet:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*

Operatori ekonomik në bashkim AD STAR, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në këtë bashkim (ku sipas kontratës së bashkëpunimit, ka marrë përsiper 50.34% të punimeve), nuk përmbush kriterin e sipërcituar. Kontrata e vetme e realizuar, paraqitur nga operatori AD STAR (Kontratë sipërmarrje për procedurën me objekt: Rikonstruksion i shkollës së mesme Fuat Babani, Bilisht Korçë, ku operatori AD STAR ka qenë me bashkim operatorësh me operatorin KEFA sh.p.k, dhe ka kryer 65% të punimeve të kësaj kontrate, të cilën e ka realizuar me një vlerë prej 30'018'489 lekë), nuk plotëson vlerën për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 32'942'500 lekë.

Ndërsa operatorët ekonomik në bashkim “MURATI” dhe EURO-ALB, e përmbushin kriterin e sipërkerkuar, në bazë të përqindjes që zotërojnë.

- Në DST Shtojca 12 , pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, në gërmën l janë kërkuar;

List pagesat sipas formularëve standart për sigurimet, për gjashtë muajt e fundit (Dhjetor të vitit 2018 dhe Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj të vitit 2019, ndërsa subjektet e biznesit të vogël sipas legjislacionit në fuqi), ku numri i punonjësve të jetë minimumi 69 persona me kohë të plotë pune, këtu përfshihet: “Stafi teknik i shoqërisë” sipas pikës “h” dhe “Licenca profesionale të shoqërisë” sipas

pikës “g” (sqarojmë se: për “Mjekun”, do të zbatohet legjislacioni në fuqi). Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi (nëpërmjet formës elektronike).

Operatorët ekonomik në bashkim “MURATI”+ AD STAR+ EURO-ALB e kanë plotësuar numrin e punonjësve 69 persona me kohë të plotë pune, por, sa i përket pikës të sipercituar, ku thuhet se në listë pagesa duhet të perfshihet dhe stafi që bën pjesë në “Licencat profesionale të shoqërisë” sipas pikës “g”, rezulton se, operatori në bashkim AD STAR nuk ka të perfshirë në listëpagesa, një punonjës drejtues teknik, i cili është pjesë e stafit në licencën profesionale të shoqërisë AD STAR e konkretisht: Ne Licecën NZ.1107/15 e Shoqërisë “AD - STAR”, Regjistruar në Regjistrin themeltar që nga data: 16.08.2016, drejtuesi teknik: NIKO MISKA, mungon në List pagesat sipas formularëve standart për sigurimet, për gjashtë muajt e fundit (Dhjetor të vitit 2018 dhe Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj te vitit 2019). Operatori ekonomik në bashkim AD STAR nuk e permbush kriterin e lartëkërkuar, ashtu sic kërkohet në DST, gjithashtu punëdhënësi AD STAR kishte detyrimin që në bazë të Ligjit “Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise”, detyrohet te derdhë kontributin e sigurimeve shoqerore dhe shëndetsore për cdo punëmarres.

KVO vendos që bashkimi i operatoreve ekonomikë “MURATI”+ AD STAR+ EURO-ALB të mos kualifikohet.

- Për operatorin ekonomikë SHENDELLI me vlerë të ofertës 46.823.022 lekë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, konstatoi se:

- Në DST Shtojca 12 , pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, ne gërmën “l” janë kërkuar;

List pagesat sipas formularëve standart për sigurimet, për gjashtë muajt e fundit (Dhjetor të vitit 2018 dhe Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj te vitit 2019, ndërsa subjektet e biznesit të vogël sipas legjislacionit në fuqi), ku numri i punonjësve të jetë minimumi 69 persona me kohë të plotë pune, këtu përfshihet: “Stafi teknik i shoqërisë” sipas pikës “h” dhe “Licenca profesionale të shoqërisë” sipas pikës “g” (sqarojmë se: për “Mjekun”, do të zbatohet legjislacioni në fuqi). Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi (nëpërmjet formës elektronike).

- Referuar listë pagesave, paraqitur nga operatori ekonomik SHENDELLI, për periudhen për gjashtë muajt e fundit (Nëntor, Dhjetor të vitit 2018 dhe Janar, Shkurt, Mars, Prill të vitit 2019), rezulton se, operatori ekonomik SHENDELLI e plotëson numrin e punonjësve 69 persona dhe e tejkalon këtë numer punonjesish, por nuk plotëson kushtin që 69 personat të jenë me kohë të plotë pune. Gjithashtu po në këtë kriter, punonjësit të cilët janë pjesë e “Stafi teknik i shoqërisë” sipas pikës “h”, jo të gjithë

janë me kohë të plotë pune.

- Në DST Shtojca 12, pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, në gërmën k, kerkuar si më poshtë;

Kërkohet certifikatë ISO 9001 e prodhuesit për cilësinë e produkteve të kërkuara më poshtë:

- dritare d/alumini plastike me dopio xham
- vetratë d/alumini plastike me dopio xham
- Kaldaje çeliku me peled me karakteristikat teknike:
 - Fuqia termike 137-190 Kë
 - Permasat jo me te < se (810 x 980 x1296) mm
- Ena e zgjerimit me karakteristika teknike jo me te < se :
 - Kapaciteti 100 l
 - Diametri: 460 mm
 - Lartësia: 690 mm
- Pompa e kodensës për kaldajen :
 - prurja: jo me e < se 9 m³ / h
- Pompa e riqarkullimi :
 - Prurja: jo me e < se 8 m³ / h

Për produktet e mësipërme, për rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues duhet të vërtetojë me marrëveshje bashkëpunimi(ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, e-mail, ëbsite, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi, si dhe duhet të paraqiten dokumenta teknike (prospekte teknike, katalog etj.) të jenë të përkthyer në ato pjesë që pasqyrojnë specifikimet teknike që kërkohen në dokumentat e tenderit.

Operatori ekonomik SHENDELLI, për produktet: *dritare d/alumini plastike me dopio xham dhe vetratë d/alumini plastike me dopio xham*, ka paraqitur një kontratë furnizimi me Ilir Alcani Çermë Fier, ku ky i fundit merr përsiper të furnizojë operatorin SHENDELLI me dyer dhe dritare druri dhe alumini. Furnizuesit Ilir Alcani i mungojnë ISO 9001 e prodhuesit dhe dokumenta teknike prospekte teknike, katalog etj.

Operatori ekonomik SHENDELLI, për produktet: *Kaldaje çeliku, Ena e zgjerimit, Pompa e kodensës për kaldajen, Pompa e riqarkullimi*, ka paraqitur një Kontratë Furnizimi e datës 06/08/2016, lidhur midis tij dhe shoqërisë HIDRO-SISTEM SHPK, ku ky i fundit merr përsiper të furnizojë operatorin SHENDELLI, po citojmë:

“Me Paisje Hidrosanitare te Ilojeve ndryshme, sistemeve te ngrohjeve te ndryshme, tubove te ndryshme, mobilje hidrosanitare, pajisje elektroshtepiake te ndryshme, materiale elektrike te ndryshme, sisteme kondicionimi te ndryshme, rakorderi te sasiseve te ndryshme, Tubacione te madhesive te ndryshme etj sipas kerkeses se POROSITESIT”. Në vijim të kësaj kontrate operatori ekonomik SHENDELLI, ka

paraqitur katalogë të ndryshëm, Certifikata ISO të ndryshme, të cilët nuk paraqesin produktet e kërkuara apo specifikime teknike që kërkohen në dokumentat e tenderit për këto produkte.

KVO vendos që operatori ekonomik SHENDELLI të mos kualifikohet.

- Për operatorin ekonomik SHAMO-CONSTRUCTION me vlerë të ofertës 48.785.127 lekë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kritereve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se:

- Në DST Shtojca 12, pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, në gërmën “k”, kërkuar si më poshtë;

Kërkohet certifikatë ISO 9001 e prodhuesit për cilësinë e produkteve të kërkuara më poshtë:

- *dritare d/alumini plastike me dopio xham*
- *vetrate d/alumini plastike me dopio xham*
- *Kaldaje çeliku me peled me karakteristikat teknike:*
 - Fuqia termike 137-190 Kë*
 - Permasat jo me te < se (810 x 980 x1296) mm*
- *Ena e zgjerimit me karakteristika teknike jo me te < se :*
 - Kapaciteti 100 l*
 - Diametri: 460 mm*
 - Lartesia: 690 mm*
- *Pompa e kodenses per kaldajen :*
 - *prurja: jo me e < se 9 m³ / h*
- *Pompa e riqarkullimi :*
 - *Prurja: jo me e < se 8 m³ / h*
- *Ndricues fluoreshent 2 x 36 ë,IP40 (ose ekuivalent me te)*
- *F.v Ndricues tavanor 1 x 40 ë (ose ekuivalent me te)*
 - *Ndricues projektor me llampe SAP-T 250 ë (ose ekuivalent me te)*

Për produktet e mësipërme, për rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues duhet të vërtetohet me marrëveshje bashkëpunimi(ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, e-mail, ëbsite, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi, si dhe duhet të paraqiten dokumenta teknike (prospekte teknike, katalog etj.) të jenë të përkthyer në ato pjesë që pasqyrojnë specifikimet teknike që kërkohen në dokumentat e tenderit.

Operatori ekonomik SHAMO-CONSTRUCTION, për produktet: *dritare d/alumini plastike me dopio xham dhe vetrate d/alumini plastike me dopio xham*, ka paraqitur certifikatë ISO 9001:2008 të prodhuesit ALUMIL S.A të pa përkthyer, të pa noterizuar dhe të pa vlevshme, vlefshmeria e saj ka mbaruar me datë 01-08-2018, gjithashtu dhe dokumentat teknike (prospekte teknike, katalog etj.) janë të

pa përkthyer në ato pjesë që pasqyrojnë specifikimet teknike që kërkohen në dokumentat e tenderit, kriter i kërkuar po në shtojcën 12 të dokumentave të tenderit, ku thuhet: “Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”.

Operatori ekonomik SHAMO-CONSTRUCTION, për produktet: *Kaldaje çeliku*, ka paraqitur certifikatë ISO 9001:2008 të prodhuesit Thermostahl Romania Sisteme Termice S.R.L të pa përkthyer, të pa noterizuar dhe të pa vlevshme, vlefshmëria e saj ka mbaruar me datë 29.012016, gjithashtu dhe dokumentat teknike (prospekte teknike, katalog etj.) janë të pa përkthyer në ato pjesë që pasqyrojnë specifikimet teknike që kërkohen në dokumentat e tenderit, , kriter i kërkuar po në shtojcën 12 të dokumentave të tenderit, ku thuhet: “Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”.

Ndërsa për produktet: *Pompa e kodensës për kaldajen, Pompa e riqarkullim*, operatori nuk ka paraqitur dokumentacion, kriter i kërkuar në DST.

Operatori ekonomik SHAMO-CONSTRUCTION, për produktet: *Ndricules fluoreshent, F.v Ndricules tavanor, Ndricules projektor me llampe*, nuk ka paraqitur certifikatë ISO 9001 të prodhuesit.

- Në DST Shtojca 12 , pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, në gërmën “l”, janë kërkuar;

List pagesat sipas formularëve standart për sigurimet, për gjashtë muajt e fundit (Dhjetor të vitit 2018 dhe Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj të vitit 2019, ndërsa subjektet e biznesit të vogël sipas legjislacionit në fuqi), ku numri i punonjësve të jetë minimumi 69 persona me kohë të plotë pune, këtu përfshihet: “Stafi teknik i shoqërisë” sipas pikës “h” dhe “Licenca profesionale të shoqërisë” sipas pikës “g” (sqarojmë se: për “Mjekun”, do të zbatohet legjislacioni në fuqi). Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi (nëpërmjet formës elektronike).

Operatori ekonomik SHAMO-CONSTRUCTION nuk i ka paraqitur listë pagesat e kërkuara.

KVO vendos që operatori ekonomik SHAMO-CONSTRUCTION të mos kualifikohet.

- Për operatorët ekonomik në bashkim COMPANY RIVIERA 2008 + K A C D E D J A me vlerë të ofertës 48.885.333 lekë, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se:

- Në DST Shtojca 12, pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, në gërmën k, kërkuar si më poshtë;

Kërkohet certifikatë ISO 9001 e prodhuesit për cilësinë e produkteve të kërkuara më poshtë:

- *Ndricules fluoreshent 2 x 36ë,IP40*

- Ndricules projektor me llampe SAP-T 250ë
- F.v Ndricules tavanor 1x40Ë

Për produktet e mësipërme, për rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues duhet të vërtetohet me marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, e-mail, ëbbsite, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi, si dhe duhet të paraqiten dokumenta teknike (prospekte teknike, katalog etj.) të jenë të përkthyer në ato pjesë që pasqyrojnë specifikimet teknike që kërkohen në dokumentat e tenderit.

Operatori ekonomik në bashkim COMPANY RIVIERA 2008, për produktet e mësipërme ka paraqitur një Kontratë Bashkëpunimi, lidhur midis tij dhe Shoqërisë ALBLIGHT, Tiranë, ku ky i fundit deklaron se është distributor për tregëtimin e materialeve elektrike, të cilën e vërteton me një Marrëveshje Ekskluzive Shpërndarje, ndërmjet tij dhe ELEKTRO CANALI spa ITALI, të cilit i mungon Çertifikata ISO 9001 e prodhuesit.

Theksojmë se çertifikata ISO 9001:2015 e Shoqërisë ALBLIGHT, Tiranë, nuk është certifikatë prodhuesi, por certifikatë për: Tregëtim, projektim dhe instalime të materialeve dhe pajisjeve elektrike. KVO vendos që bashkimi i operatorëve ekonomikë COMPANY RIVIERA 2008 + KA C D E D J A të mos kualifikohet.

- Për operatorin ekonomik EVEREST me vlerë të ofertës 49.227.292 lekë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se:

Operatori ekonomik EVEREST e ka paraqitur Shtojcën 2/1 “Deklaratë për paraqitje oferte të pavaruar”, por nuk ka klikuar një nga alternativat e pikës 6(*germen a ose germen b*), te kësaj shtojce.

- Në DST Shtojca 12 , pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, ne germen I jane kerkuar;

List pagesat sipas formularëve standart për sigurimet, për gjashtë muajt e fundit (Dhjetor të vitit 2018 dhe Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj te vitit 2019, ndërsa subjektet e biznesit të vogël sipas legjislacionit në fuqi), ku numri i punonjësve të jetë minimumi 69 persona me kohë të plotë pune, këtu përfshihet: “Stafi teknik i shoqërisë” sipas pikës “h” dhe “Licenca profesionale të shoqërisë” sipas pikës “g” (sqarojmë se: për “Mjekun”, do të zbatohet legjislacioni në fuqi). Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi (nëpërmjet formës elektronike).

Operatori ekonomik EVEREST e ploteson numrin e punonjesve 69 persona me kohë të plotë pune dhe e tejkalon këtë numër, por, sa i përket pikës së sipercituar, ku thuhet se ne listë pagesa duhet të përfshihet dhe stafi që bën pjesë në “Licencat profesionale të shoqërisë” sipas pikës “g”, rezulton se,

operatori ekonomik EVEREST, nuk ka përfshirë në listë pagesa, dy punonjes drejtues teknik, të cilët janë pjesë e stafit në licencën profesionale të shoqërisë EVEREST e konkretisht: Në Licencën NZ.2657/15 e Shoqërisë “EVEREST”, *Regjistruar në Regjistrin themeltar që nga data: 18.04.2017*, drejtuesit teknik: MANDIOLA KASAJ mungon në List pagesat sipas formularëve standart për sigurimet, për gjashtë muajt e fundit (Dhjetor të vitit 2018 dhe Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj te vitit 2019) dhe ERJON NDOJ mungon në List pagesat sipas formularëve standart për sigurimet, për tre muajt e fundit (Mars, Prill, Maj te vitit 2019). Operatori ekonomik EVEREST nuk e përmbush kriterin e lartë kërkuar, ashtu sic kërkohet në DST, gjithashtu punëdhënësi EVEREST kishte detyrimin që në bazë të Ligjit “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, detyrohet të derdhë kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore për çdo punëmarrës.

- Në DST Shtojca 12, pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, në gjurmën k, kërkuar si më poshtë;

Kërkohet certifikatë ISO 9001 e prodhuesit për cilësinë e produkteve të kërkuara më poshtë:

- *Pompa e kodenses per kaldajen :*
 - *prurja: jo me e < se 9 m³ / h*
- *Pompa e riqarkullimi :*
 - *Prurja: jo me e < se 8 m³ / h*
- *Ndricues fluoreshent 2 x 36 ë,IP40 (ose ekuivalent me te)*
- *F.v Ndricues tavanor 1 x 40 ë (ose ekuivalent me te)*
- *Ndricues projektor me llampe SAP-T 250 ë (ose ekuivalent me te)*

Për produktet e mësipërme, për rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues duhet të vërtetojë me marrëveshje bashkëpunimi(ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, e-mail, ëbbsite, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi, si dhe duhet të paraqiten dokumenta teknike (prospekte teknike, katalog etj.) të jenë të përkthyer në ato pjesë që pasqyrojnë specifikimet teknike që kërkohen në dokumentat e tenderit.

Operatori ekonomik EVEREST për produktet: *Pompa e kodenses per kaldajen*, nuk është prodhues dhe nuk ka marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar e cila të tregojë lidhjen midis tij dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues.

Operatori ekonomik EVEREST, për produktet: *Ndricues fluoreshent, Ndricues projektor me llampe, F.v Ndricues tavanor*, dokumentat teknike (prospekte teknike, katalog etj.) nuk i ka të përkthyer në ato pjesë që pasqyrojnë specifikimet teknike që kërkohen në dokumentat e tenderit, kriter i kërkuar po në shtojcën 12 të dokumentave të tenderit, ku thuhet: “Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në

gjuhën shqipe”.

KVO vendos që operatori ekonomik EVEREST të mos kualifikohet.

- Për operatorin ekonomik KUPA me vlerë të ofertës 49.511.839 lekë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kritereve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se:

- Në DST Shtojca 12, pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, në gjurmën k, kërkuar si më poshte;

Kërkohej certifikatë ISO 9001 e prodhuesit për cilësinë e produkteve të kërkuara më poshtë:

- *dritare d/alumini plastike me dopio xham*
- *vetrate d/alumini plastike me dopio xham*
- *Kaldaje çeliku me peled me karakteristikat teknike:*
 - Fuqia termike 137-190 Kë
 - Permasat jo me te < se (810 x 980 x1296) mm
- *Ena e zgjerimit me karakteristika teknike jo me te < se :*
 - Kapaciteti 100 l
 - Diametri: 460 mm
 - Lartësia: 690 mm
- *Pompa e kodenses per kaldajen :*
 - prurja: jo me e < se 9 m³ / h
- *Pompa e riqarkullimi :*
 - Prurja: jo me e < se 8 m³ / h

Për produktet e mësipërme, për rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues duhet të vërtetohet me marrëveshje bashkëpunimi(ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, e-mail, ëbsite, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi, si dhe duhet të paraqiten dokumenta teknike (prospekte teknike, katalog etj.) të jenë të përkthyer në ato pjesë që pasqyrojnë specifikimet teknike që kërkohen në

Operatori ekonomik KUPA për produktet: *dritare d/alumini plastike me dopio xham, vetrate d/alumini plastike me dopio xham*, ka paraqitur dokumentatat e prodhuesit të këtyre produkteve, por nuk kanë bërë marrëveshje midis tyre.

Operatori ekonomik KUPA për produktet *Kaldaje çeliku, Ena e zgjerimit, Pompa e kodenses per kaldajen, Pompa e riqarkullimi*, ka paraqitur një Kontratë Furnizimi, lidhur midis tij dhe Ilir Blloshmi, me adrese Kavaje, me Nr. NIPT L13203801D, ku ky i fundit merr persiper të furnizojë opertorin KUPA me keto produkte. Dokumentat teknike (prospekte teknike, katalog etj.)te kaldajes, nuk jane të përkthyer dhe as te noterizuara në ato pjesë që pasqyrojnë specifikimet teknike që kërkohen në dokumentat e tenderit, kriter i

kerkuar po në shtojcën 12 të dokumentave të tenderit, ku thuhet: “Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”. Ndërsa për *Pompat*, operatori KUPA nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar si: ISO 9001 e prodhuesit dhe dokumenta teknike (prospekte teknike, katalog etj.), kritere keto të kërkuara në DST.

KVO vendos që operatori ekonomik KUPA të mos kualifikohet.

- Për operatorin ekonomik “SHKELQIMI 07” me vlerë të ofertës 50.000.000 lekë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kritereve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se: Në DST Shtojca 12, pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, në gjurmën k, kërkuar si më poshtë;

Kërkohej certifikatë ISO 9001 e prodhuesit për cilësinë e produkteve të kërkuara më poshtë:

- *dritare d/alumini plastike me dopio xham*
- *vetrate d/alumini plastike me dopio xham*
- *Kaldaje çeliku me peled me karakteristikat teknike:*
 - Fuqia termike 137-190 Kë*
 - Permasat jo me te < se (810 x 980 x1296) mm*
- *Ena e zgjerimit me karakteristika teknike jo me te < se :*
 - Kapaciteti 100 l*
 - Diametri: 460 mm*
 - Lartësia: 690 mm*
- *Pompa e kodenses per kaldajen :*
 - *prurja: jo me e < se 9 m³ / h*
- *Pompa e riqarkullimi :*
 - *Prurja: jo me e < se 8 m³ / h*
- *Ndricues fluoreshent 2 x 36 ë,IP40 (ose ekuivalent me te)*
- *F.v Ndricues tavanor 1 x 40 ë (ose ekuivalent me te)*
- *Ndricues projektor me llampe SAP-T 250 ë (ose ekuivalent me te)*

Për produktet e mësipërme, për rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues duhet të vërtetohet me marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, e-mail, ëbsite, etj, kjo e nevojshme për

Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi, si dhe duhet të paraqiten dokumenta teknike (prospekte teknike, katalog etj.) të jenë të përkthyer në ato pjesë që pasqyrojnë specifikimet teknike që kërkohen në dokumentat e tenderit.

Operatori ekonomik “SHKELQIMI 07” për produktet: *dritare d/alumini plastike me dopio xham, vetrate d/alumini plastike me dopio xham*, ka bërë marrëveshje bashkëpunimi me distributorin e prodhuesit të këtyre produkteve, por ISO 9001:2008 e prodhuesit LASTIMMA S.R.L Itali, ka skaduar që me datë 25.06.2015.

Operatori ekonomik “SHKELQIMI 07” për produktet: *Kaldaje çeliku, Ena e zgjerimit, Pompa e kodenses per kaldajen, Pompa e riqarkullimi*, nuk është prodhues i këtyre produkteve dhe nuk ka marrëveshje bashkëpunimi me prodhues apo distributor të këtyre produkteve.

Një marrëveshje furnizimi e datës 13/10/2016, lidhur midis ofertuesit “SHKELQIMI 07” dhe shoqërisë “SYSTEM GROUP ALBANIA” sh.p.k është bërë për furnizimin nga ky i fundit me produkte: *Tuba polietileni për sisteme ujesjelles kanalizime, tuba dhe rekorderi celiku dhe Matesa uji*, produkte keto që nuk kanë lidhje me ato cfar janë kërkuar në DST.

Operatori ekonomik “SHKELQIMI 07” për produktet: *Ndricules fluoreshent, Ndricules projektor me llampe, F.v Ndricules tavanor*; dokumentat teknike (prospekte teknike, katalog etj.) nuk i ka të përkthyer në ato pjesë që pasqyrojnë specifikimet teknike që kërkohen në dokumentat e tenderit, kriter i kerkuar po në shtojcën 12 të dokumentave të tenderit, ku thuhet: “*Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe*”.

KVO vendos që operatori ekonomik “SHKELQIMI 07” të mos kualifikohet.

- Për operatorin ekonomik SIRETA 2F me vlerë të ofertës 52.588.333 lekë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se:

- Në DST Shtojca 12, pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, në gjermën k, kërkuar si më poshtë;

Kërkohe certifikatë ISO 9001 e prodhuesit për cilësinë e produkteve të kërkuara më poshtë:

- *Kaldaje çeliku me peled me karakteristikat teknike:*
 - Fuqia termike 137-190 Kë
 - Permasat jo me te < se (810 x 980 x1296) mm
- *Ena e zgjerimit me karakteristika teknike jo me te < se :*
 - Kapaciteti 100 l

-Diametri: 460 mm

-Lartesia: 690 mm

- Pompa e kodenses per kaldajen :

- prurja: jo me e < se 9 m³ / h

- Pompa e riqarkullimi :

- Prurja: jo me e < se 8 m³ / h

Për produktet e mësipërme, për rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues duhet të vërtetohet me marrëveshje bashkëpunimi(ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, e-mail, ëbsite, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi, si dhe duhet të paraqiten dokumenta teknike (prospekte teknike, katalog etj.) të jenë të përkthyer në ato pjesë që pasqyrojnë specifikimet teknike që kërkohen në dokumentat e tenderit.

Operatori ekonomik SIRETA 2F për produktet: *Kaldaje çeliku, Ena e zgjerimit, dokumentat teknike (prospekte teknike, katalog etj.)* nuk i ka të përkthyer në ato pjesë që pasqyrojnë specifikimet teknike që kërkohen në dokumentat e tenderit, kriter i kërkuar po në shtojcën 12 të dokumentave të tenderit, ku thuhet: *“Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”.*

Operatori ekonomik SIRETA 2F për produktet: *Pompa e kodenses per kaldajen, Pompa e riqarkullim,* nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar si: *ISO 9001 e prodhuesit dhe dokumenta teknike (prospekte teknike, katalog etj.),* kritere keto të kërkuara në DST.

KVO vendos që operatori ekonomik SIRETA 2F të mos kualifikohet.

- Për operatorët në bashkim AURORA KONSTRUKSION + XHENGO me vlerë të ofertës 52.604.757 lekë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kritereve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se:

- Në DST Shtojca 12 , pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, në gjermën I janë kërkuar;

List pagesat sipas formularëve standart për sigurimet, për gjashtë muajt e fundit (Dhjetor të vitit 2018 dhe Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj te vitit 2019, ndërsa subjektet e biznesit të vogël sipas legjislacionit në fuqi), ku numri i punonjësve të jetë minimumi 69 persona me kohë të plotë pune, këtu përfshihet: “Stafi teknik i shoqërisë” sipas pikës “h” dhe “Licenca profesionale të shoqërisë” sipas pikës “g” (sqarojmë se: për “Mjekun”, do të zbatohet legjislacioni në fuqi). Dokumenta të konfirmuara

nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi (nëpërmjet formës elektronike).

Operatorët në bashkim AURORA KONSTRUKSION + XHENGO e plotesojne numrin e punonjësve 69 persona me kohë të plotë pune dhe e tejkalojnë këtë numër, por, sa i përket pikës të sipërcituar ku thuhet se, në listë pagesa, duhet të perfshihet me kohë të plotë pune dhe stafi që bën pjesë në “Licencat profesionale të shoqërisë” sipas pikës “g”, rezulton se, operatori ekonomik në bashkim AURORA KONSTRUKSION, punonjës drejtues teknik, të cilët janë pjesë e stafit në licencën profesionale të shoqërisë AURORA KONSTRUKSION e konkretisht: Në Licencën NZ.3558/10, të Shoqërisë “AURORA KONSTRUKSION”, *Regjistruar në Regjistrin themeltar që nga data: 23.03.2018*, konkretisht drejtuesi teknik: Arqitektja MARSELA VOLAJ, Inxhinieri Gjeodet(Topograf) GEZIM MALINDI(HASKO), nuk janë me kohë të plotë pune. Gjithashtu dhe operatori tjetër ekonomik në bashkim XHENGO, dy nga punonjësit drejtues teknik, të cilët janë pjesë e stafit në licencën profesionale të shoqërisë XHENGO e konkretisht: Në Licencën NZ.1251/10, të Shoqërisë “XHENGO”, *Regjistruar në Regjistrin themeltar që nga data: 03.04.2019*, drejtuesit teknik: GJERGJI QIRJOLLARI dhe EVIS MELONASHI nuk janë me kohë të plote pune.

Operatorët në bashkim AURORA KONSTRUKSION + XHENGO nuk e përmbushin kriterin e lartëkërkuar, ashtu sic kerkohet në DST.

- Në DST Shtojca 12, pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, në gërmën k, kerkuar si me poshte;

Kërkohet certifikatë ISO 9001 e prodhuesit për cilësinë e produkteve të kërkuara më poshtë:

- *Kaldaje çeliku me peled me karakteristikat teknike:*
 - Fuqia termike 137-190 Kë
 - Permasat jo me te < se (810 x 980 x1296) mm
- *Ena e zgjerimit me karakteristika teknike jo me te < se :*
 - Kapaciteti 100 l
 - Diametri: 460 mm
 - Lartesia: 690 mm
- *Pompa e kodenses per kaldajen :*
 - prurja: jo me e < se 9 m³ / h
- *Pompa e riqarkullimi :*
 - Prurja: jo me e < se 8 m³ / h
- *Ndricues fluoreshent 2 x 36 ë,IP40 (ose ekuivalent me te)*
- *F.v Ndricues tavanor 1 x 40 ë (ose ekuivalent me te)*
- *Ndricues projektor me llampe SAP-T 250 ë (ose ekuivalent me te)*

Për produktet e mësipërme, për rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues duhet të vërtetohet me marrëveshje bashkëpunimi(ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe

prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, e-mail, ëebsite, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi, si dhe duhet të paraqiten dokumenta teknike (prospekte teknike, katalog etj.) të jenë të përkthyer në ato pjesë që pasqyrojnë specifikimet teknike që kërkohen në dokumentat e tenderit.

Operatori në bashkim AURORA KONSTRUKSION, për produktet: *Kaldaje çeliku, Ena e zgjerimit, dokumentat teknike (prospekte teknike, katalog etj.)* nuk i ka të përkthyer në ato pjesë që pasqyrojnë specifikimet teknike që kërkohen në dokumentat e tenderit, kriter i kërkuar po në shtojcën 12 të dokumentave të tenderit, ku thuhet: “Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”.

Operatori në bashkim AURORA KONSTRUKSION për produktet: *Pompa e kodensës për kaldajen, Pompa e riqarkullim,* nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar si: ISO 9001 e prodhuesit dhe dokumenta teknike (prospekte teknike, katalog etj.), kritere këo të kërkuar në DST.

Operatori në bashkim AURORA KONSTRUKSION për produktet: *Ndricules fluoreshent, Ndricules projektor me llampe, F.v Ndricules tavanor,* dokumentat teknike (prospekte teknike, katalog etj.) nuk i ka të përkthyer në ato pjesë që pasqyrojnë specifikimet teknike që kërkohen në dokumentat e tenderit, kriter i kërkuar po në shtojcën 12 të dokumentave të tenderit, ku thuhet: “Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”.

KVO vendos që bashkimi i operatorëve ekonomike AURORA KONSTRUKSION + XHENGO të mos kualifikohet.

- Për operatorin ekonomik B - 93 me vlerë të ofertës 54.030.053 lekë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kritereve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se:

- Në DST Shtojca 12 , pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, në gërmën I janë kerkuar;

List pagesat sipas formularëve standart për sigurimet, për gjashtë muajt e fundit (Dhjetor të vitit 2018 dhe Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj te vitit 2019, ndërsa subjektet e biznesit të vogël sipas legjislacionit në fuqi), ku numri i punonjësve të jetë minimumi 69 persona me kohë të plotë pune, këtu përfshihet: “Stafi teknik i shoqërisë” sipas pikës “h” dhe “Licenca profesionale të shoqërisë” sipas pikës “g” (sqarojmë se: për “Mjekun”, do të zbatohet legjislacioni në fuqi). Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi (nëpërmjet formës elektronike).

- Referuar listë pagesave, paraqitur nga operatori ekonomik B - 93, për periudhën për gjashtë muajt e

fundit (Nëntor, Dhjetor të vitit 2018 dhe Janar, Shkurt, Mars, Prill të vitit 2019), rezulton se, operatori ekonomik B - 93 e plotëson numrin mesatar të punonjësve 69 persona, por nuk plotëson kushtin që 69 personat të jenë me kohe të plotë pune.

- Në DST Shtojca 12, pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, në gjurmën k, kërkuar si me poshtë;

Kërkohet certifikatë ISO 9001 e prodhuesit për cilësinë e produkteve të kërkua më poshtë:

- dritare d/alumini plastike me dopio xham
- vetratë d/alumini plastike me dopio xham
- Kaldaje çeliku me peled me karakteristikat teknike:
 - Fuqia termike 137-190 Kë
 - Permasat jo me te < se (810 x 980 x1296) mm
- Ena e zgjerimit me karakteristika teknike jo me te < se :
 - Kapaciteti 100 l
 - Diametri: 460 mm
 - Lartësia: 690 mm
- Pompa e kodenses per kaldajen :
 - prurja: jo me e < se 9 m³ / h
- Pompa e riqarkullimi :
 - Prurja: jo me e < se 8 m³ / h
- Ndricues fluoreshent 2 x 36 ë,IP40 (ose ekuivalent me te)
- F.v Ndricues tavanor 1 x 40 ë (ose ekuivalent me te)
- Ndricues projektor me llampe SAP-T 250 ë (ose ekuivalent me te)

Për produktet e mësipërme, për rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues duhet të vërtetohet me marrëveshje bashkëpunimi(ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, e-mail, ëbbsite, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi, si dhe duhet të paraqiten dokumenta teknike (prospekte teknike, katalog etj.) të jenë të përkthyer në ato pjesë që pasqyrojnë specifikimet teknike që kërkohen në dokumentat e tenderit.

Operatori ekonomik B – 93 për produktet e lartëkërkua nuk është prodhues i tyre, pasi nuk e provon me asnjë dokument, por dhe nuk ka marrëveshje me prodhues apo distributorë të këtyre produkteve. Mungojnë certifikatat ISO 9001 të prodhuesit dhe dokumenta teknike (prospekte teknike, katalog etj.). KVO vendos operatorin ekonomik B – 93 të mos kualifikohet.

- Operatori ELDA-VL nuk ka paraqitur ofertë. KVO vendos që operatorin të mos kualifikohet.

KVO vazhdon shqyrtimin e ofertave të kualifikuara për gabime arithmetike, ku rezultojnë të rregullta

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se: HTM + BE-IS shpk, Adresa: Shkoder, Lagja Perash, Rruga Rrojej, Nr. 449, oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej 43.950.000(dyzet e tre milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkise Durrës, Sheshi “Liria” Durrës, tel/fax 052222310, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) diteve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [45.263.380(dyzet e pesë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e treqind e tetëdhjetë) lekë], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 24.07.2019.

Ankesa: ka ose jo __ Jo __

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

Titullar i Autoritetit Kontraktor

Zyrtari i autorizuar

Etleva Kondi